



**AKT - THEMELIMI**  
**PER KRIJIMIN E SHOQERISE**  
**“CONCORD-Travel-Tours”**

Sot me daten 25.10. 1999,

**1- Skerdi DAFA**, banues ne rrugen: “Hasan Vogli”, Pall. 6, Ap. 6, Tirane, qe nderhyn me cilesine e ortakut dhe te Administratorit te vetem te Shoqerise “ **CONCORD** Travel Tours”

**2-Raimonda KOSHAJ**, banuese ne Tirane, ne rrugen “Luigj Gurakuqi”, pall 14 ap - 3: qe nderhyn me cilesine e ortakut te Shoqerise “ **CONCORD**”.

(.) **U MBLODHEN DHE FORMUAN**

**AKT THEMELIMI NR 1**

art. 1

Eshte krijuar ndermjet paleve te mesiperme Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar me emrin : “CONCORD Travel Tours”

art. 2

**Qendra** ligjore e Shoqerise eshte fiksuar ne Shqiperi, tek “ Tirana Bisnes Center”, Tirane. Shoqeria do te kete te drejte te krijoje dege, filiale ose zyra te perfaqsimi te saj brenda teritorit te Republikes se Shqiperise.  
Vendimi per krijimin e tyre merret nga te dy ortaket . Ne te njehiten menyre procedohet edhe per anulimin e tyre.

art 3

Qellimi i Shoqerise eshte percaktuar nga neni 8 i Statutit te Shoqerise sikur eshte lidhur si me poshte.

**Objekti i veprimtarisë** së Shoqërisë do të përfshijë kryesisht:

- Agjensi te udhetimeve turistike

art 4

**Kohezgjatja** e Shoqerise eshte fiksuar deri me 31.12.2010 me te drejte perseritje ne heshtje.

art.5

**Shoqeria do te filloje veprimtarine** e saj tregtare ne Shqiperi nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se rrethit Tirane.

Skend: Dafa  
Sadafa

Raimonda Koshaj  
Koshaj



art.6

**Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin** e saj në përputhje me ligjin "Për Shoqërite Tregtare", legjisllacionin e përgjithshëm në fuqi në Shqipëri, si dhe në përputhje me parashikimet e Statusit të saj.

art.7

Shoqëria do të ketë **vulën** e saj për ta përdorur në të gjithë dokumentet dhe në korrespondencën me subjekte private e shtetërore. Vula do të përdoret nga administratori i saj në rast se dokumentat nuk kanë të bëjnë me kompetenca që shprehimisht u njihen me ligj e me këte statut ortakeve .

art.8

**Kapitali i Shoqërisë** në ditën e krijimit të saj është 100.000 Lek. Ai ndahet në dy kuota nga 50 000 lek secila , që janë kontributet e secilit prej ortakeve në kapitalin fillestar

art.9

**Shlyerja e kapitalit themeltar** do të vërtetohet me një dokument të një banke dhe regjistrohet në Regjistrin Tregtar.

art.10

**Kapitali shtesë**, në rast se ortaket me vendosin të bëjnë shtesë, duhet të vërtetohet nga një dokument i një Banke, në rast se ajo është bërë në të holla, dhe nga një raport vlerësues sipas klauzolave të Ligjit "Për shoqëritë tregtare" në rast se ajo bëhet në natyrë.

art.11

Transferimi i pjeseve të kapitalit

Pjeset e kapitalit të Shoqërisë mund të transferohen lirisht ndërmjet ortakeve. Në këte rast, ortaku që dësheron të transferojë pjesë të tij të kapitalit duhet të njoftojë me shkrim ortakut, ose administratorit të vetëm për ekzekutimin e transaksionit përkatës, në noter publik.

Pjeset e kapitalit të Shoqërisë , mund të shiten ose transferohen jashtë teresise se ortakeve vetëm me miratimin e tyre.

Transferimi i plote i kuotave nga ndonjeri prej ortakeve sjelle automatikisht daljen e tij nga shoqëria . Ky ndryshim pasqyrohet në statusin e shoqërisë, dhe i njoftohet Gjykatës së Rrethit të Tiranës nga administratori i vetëm.

Skërdi Dajë  
S. Dajë

2  
Rimonda Kashaj  
Rimonda Kashaj

art. 12

### Ushtrimi i veprimtarisë

Ushtrimoret e Shoqërisë përputhen me vitin kalendarik duke filluar nga 1 janari e deri më 31 dhjetor.

Përfundimisht ushtrimi i parë do të filloj nga dita e regjistrimit të Shoqërisë.

art. 13

### Bilanci, kontabiliteti.

Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet dhe miratohet nga administratori dhe ortaku i vetëm për t'u paraqitur përpara organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit në vazhdim.

Kontabiliteti mbahet sipas ligjit "Mbi Kontabilitetin" dhe dispozitat në fuqi.

art. 14

### Fitimi, ndarja e tij

Shoqëria do të krijoj rezervë për të realizuar qëllimet e saja.

Fitimet e Shoqërisë pas mbylljes së çdo ushtrimi pasi t'i nënshtrohen tatimit do të ndahen midis ortakëve në proporcion të barabartë.

Humbjet e Shoqërisë mbullohen deri në kufirin e kapitalit të saj dhe secili prej ortakëve përgjigjet deri në kufirin e vlerës së kontributeit të tij në kapitalin e Shoqërisë. Humbjet mund të mbarten nga mbyllja e ushtrimit të parë deri në tre ushtrimorë pasardhës.

## MARRJA E VENDIMEVE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Vendimet kryesore të Shoqërisë merren në asambletë e ortakëve, ose me anë të konsultimeve me shkrim të ortakëve.

Çdo ortak zoteron 1/2 e votave. Një ortak mund të përfaqësohet nga një person i autorizuar

Asambleja e ortakëve shqyrton dhe merr vendime për çështjet e mëposhtme:

- aprovimi i bilancit, i pasqyrës së fitimeve dhe humbjeve;
- zvogëlimi ose zmadhimi i kapitalit;
- emërimi i Administratorit të vetëm ose shkarkimi i tij;
- hartimi dhe miratimi i planit të biznesit dhe investimeve;
- mbyllja e veprimtarisë së Shoqërisë;
- shndërrimi i shoqërisë nga me përgjegjësi të kufizuar në ndonjë formë tjetër;
- ndryshimi i Statusit të Shoqërisë;
- miratimi i ekspertit kontabël ose likuidatorit të emëruar nga administratori;

Skenderi Daj  
S. Daj

Raimondo Kshaj  
3



art.15

### **Administratori i Vetëm**

Administrator i Vetem do te jete zt.Skerdi DAFA i cili do te drejtoje aktivitetin e zakonshem te shoqerise ne mirkuptim me ortakun e shoqerise .

Ne vecanti Administratori i Vetem do te jete pergjegjes per :

1. Drejtimin e perditshem te aktivitetit te shoqerise
2. Perfaqsimin e shoqerise ne mardhenie me te tretet
3. Hartimin dhe mbajtjen kontabilitetit te shoqerise, emerimin e expertit kontabel
4. Organizimin e punes brenda shoqerise .
5. Ekzekutimin e dokumentave ne emer te shoqerise, sipas autorizimit te dhene
6. Pergatitjen e mledhjes se ortakeve dhe kryerjen e lajmerimit
7. Zhvillime te te gjitha aktiviteve te tjera me autorizim te ortakeve .

### **LIKUJDIMI I SHOQERISE**

art. 16

Shoqeria do te likujdohet para mbarimit te parashikuar nga ky Statut ne rast se dhe kur;

1.Ortaket vendosn te mbyllin veprimtarine e shoqerise.

Ne rast se vendimi per likujdimin e shoqerise eshte marre, ortaket do te caktojne nje likujdator , i cili do te jete pergjegjes te likujdoje pasurite e shoqerise dhe te paguaj kreditorët. pas pageses perfundimtare te kreditoreve sipas radhes , pjesa e mbetur i shperndahet Ortakeve ne perpjestim me kuotat e tyre ne kapitalin e shoqerise.

### **DISPOZITA TE TJERA**

art.17

Ne rast mosmarrveshje te mundshme midis ortakeve , atyre u lind e drejta qe nese deshtojne perpjekjet per zgjidhjen me pajtim , ti drejtohen Gjykates se Rrethit .

Ky Akt - Themelimi u nenshkrua nga ortaku i vetem themelues sot, me 25.10.1999

Ortaket Themelue

1. Skerdi DAFA

2. Raimonda KOSHAJ



# STATUTI I SHOQËRISË "CONCORD-Travel-Tours"

## 1. KRIJIMI

### NENI 1 Ortaket

1.1. "CONCORD" është themeluar nga ortaket: 1. **Skerdi Dafa**, i biri i Pandeliut, datelindja 1975, lindur ne Tirane, banues ne Tirane, rruga Hasan Vogli, Pall. 6, Ap-6, dhe 2. **Raimonda Koshaj**, e bija e Hidajetit, datelindja 1958, lindur ne Elbasan, banues ne Tirane, Rr: Qamil Guranjaku, Pall. 14, Ap-3.

### NENI 2 Emertimi

2.1. Shoqëria emertohet: "**CONCORD-Travel-Tours**"

### NENI 3 Forma

3.1 Shoqëria do te jete me pergjegjsi te kufizuar (SH.PK)

### NENI 4 Fitimi i Personalitetit Juridik

4.1 Shoqëria do te filloje veprimtarine e saj tregtare ne Shqiperi nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar prane gjykates se rrethit Tirane.

4.2. Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj në përputhje me ligjin "Për Shoqëritë Tregtare", legjisllacionin e përgjithshëm në fuqi në Shqipëri, si dhe në përputhje me parashikimet e Statusit të saj.

### NENI 5 Kohëzgjatja

5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë se Shoqërisë është parashikuar dhjetë vjetë e një ditë me të drejtë zgjatjeje në heshtje.

### NENI 6. Selia

6.1. Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë, "Tirana Bisnes Center".

6.2. Shoqëria do të ketë të drejtë të krijoj degë e filiale ose zyra përfaqësimi të saj brenda teritorit të Shqipërisë.

6.3. Vendimi për krijimin e tyre merret nga të dy ortakët. Në të njëjtën mënyrë procedohet edhe për anulimin e tyre.

Skerdi Dafa  
S. Dafa

Raimonda Koshaj  
R. Koshaj

NENI 7. Vula

7.1. Shoqëria do të ketë vulën e saj për ta përdorur në të gjithë dokumentet dhe në korrespondencën me subjekte private e shtetërore. Vula do të përdoret nga administratori i vetëm në rast se dokumentat nuk kanë të bëjnë me kompetenca që shprehimisht u njihen me ligj e me këtë Statut ortakëve.

NENI 8. Objekti

8.1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë kryesisht:

- agjensi e udhetimeve turistike;

NENI 9. Kapitali

9.1. Kapitali i Shoqërisë në ditën e krijimit të saj është 100.000 Lek. Ai ndahet në dy kuota nga 50.000 Lek secila, që janë kontributet e secilit prej ortakëve në kapitalin fillestar.

9.2. Shlyerja e kapitalit themeltar do të vërtetohet me një dokument të një Banke dhe regjistrohet në Regjistrin Tregtar.

9.3. Kapitali shtesë, në rast se ortakët vendosin të bëjnë shtesë, duhet të vërtetohet nga një dokument i një Banke, në rast se ajo është bërë në të holla, dhe nga një raport vierësues sipas klauzolave të Ligjit "Për shoqëritë tregtare" në rast se ajo bëhet në natyrë.

NENI 10. Transferimi i pjesëve të kapitalit

10.1. Pjesët e kapitalit të Shoqërisë mund të transferohen lirisht ndërmjet ortakëve. Në këtë rast, ortaku që dëshiron të transferoj pjesë të tij të kapitalit duhet t'i njoftoj me shkrim ortakut ose administratorit të vetëm për ekzekutimin e transaksionit përkatës, një noter publik.

10.2. Pjesët e kapitalit të Shoqërisë mund të shiten ose transferohen jashtë tërësisë së ortakëve vetëm me miratimin e tyre.

10.3. Transferimi i plotë i kuotave nga ndonjëri prej ortakëve sjellë automatikisht daljen e tij nga Shoqëria. Ky ndryshim pasqyrohet në Statutin e Shoqërisë dhe i njoftohet Gjykatës së rrethit Tiranë nga administratori i vetëm.

NENI 11. Ushtrimi i veprimtarisë

11.1. Ushtrimoret e Shoqërisë përputhen me vitin kalendarik duke filluar nga 1 janari e deri më 31 dhjetor.

Përfundimisht ushtrimi i parë do të filloj nga dita e regjistrimit të Shoqërisë.

Skendi Dajçi  
Sulaj

2  
Rimonda Kohaj  
R.K.



## NENI 12. Bilanci, kontabiliteti.

12.1. Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet në mbledhjen e ortakëve dhe duhet të përgaditet për t'u paraqitur përpara organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit në vazhdim.

12.2. Kontabiliteti mbahet sipas Ligjit "Mbi Kontabilitetin" dhe dispozitat në fuqi.

## NENI 13. Fitimi, ndarja e tij

13.1. Shoqëria do të krijojë rezerva për të realizuar qëllimet e saj.

13.2. Fitimet e Shoqërisë pas mbylljes së çdo ushtrimori pasi t'i nënshtrohen tatimit do të ndahen midis ortakëve në proporcion të barabartë.

13.3. Humbjet e Shoqërisë mbulohen deri në kufirin e kapitalit të saj dhe secili prej ortakëve përgjigjet deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë. Humbjet mund të mbarten nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorë pasardhës.

## MARRJA E VENDIMEVE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### NENI 14. Asambleja e ortakëve

14.1. Vendimet kryesore të Shoqërisë merren në asamblenë e ortakëve ose me anë të konsultimeve me shkrim të ortakëve.

14.2. Çdo ortak zotëron 1/2 të votave.

14.3. Një ortak mund të përfaqësohet nga një person i autorizuar.

14.4. Asambleja e ortakëve shqyrton dhe merr vendime për çështjet e mëposhtme:

- aprovimi i bilancit, i pasqyrës së fitimeve dhe humbjeve;
- zvogëlimi ose zmadhimi i kapitalit;
- emërimi i Administratorit të vetëm ose shkarkimi i tij;
- hartimi dhe miratimi i planit të biznesit dhe investimeve;
- mbyllja e veprimtarisë së Shoqërisë;
- shndërrimi i shoqërisë nga me përgjegjësi të kufizuar në ndonjë formë tjetër;
- ndryshimi i Statusit të Shoqërisë;
- miratimi i ekspertit kontabël ose likuidatorit të emëruar nga administratori;

### NENI 15. Administratori i Vetëm.

15.1. Administrator i Vetëm do të jetë **zt. Skerdi Dafa** i cili dote drejtoje aktivitetin e zakonshëm të Shoqërisë në mirkuptim të ortakun e tij.

Skendi Dafa  
Sodafa

Skendi Dafa<sup>3</sup>  
Sodafa



15.2. Në veçanti Administratori i Vetëm do të jetë përgjegjës për :

1. Drejtimin e përditshëm të aktivitetit të Shoqërisë;
2. Përfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët;
3. Përgatitjen e mbledhjes së Ortakëve dhe kryerjen e lajmerimit;
4. Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit të Shoqërisë, emërimin e ekspertit kontabel;
5. Organizimin e punës brenda Shoqërisë dhe raportimin para Ortakëve;
6. Ekzekutimin e dokumentave në emër të shoqërisë, sipas autorizimit të dhënë;
7. Të propozojë Asamblese të Ortakëve projekte të reja biznesi;
8. Zhvillime të gjitha aktiviteteve të tjera me autorizim të Ortakëve.

## LIKUJDIMI I SHOQËRISË

### NENI 16

16.1. Shoqëria do të likujdohet para mbarimit të parashikuar nga ky Statut në rast se dhe kur: Ortaket vendosin unanimisht të mbyllin veprimtarinë e Shoqërisë

16.2. Në rast se vendimi për likuidimin e Shoqërisë është marrë, ortaket do të caktojnë një likuidator, i cili do të jetë përgjegjës të likujdojë pasuritë e Shoqërisë dhe të paguaj kreditorët, pas pagesës përfundimtare të kreditorëve sipas radhës. pjesa e mbetur u shpërndahet Ortakëve në përpjestim me kuotat e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

## DISPOZITA TË TJERA

### NENI 17

17.1. Në rast mosmarrvëshjesh të mundshme midis Ortakëve, atyre u lind e drejta që, nëse deshtojnë përpjekjet për zgjidhjen me pajtim, të drejtohen Gjykatës së Rrethit

17.2. Ky Statut u nënshkrua nga ortaket themelues sot, më 25.10.1999

Ortakët :

1. Skerdi DAFA

2. Raimonda KOSHAJ